



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke*  
*Ministry of Education and Science*

**07.04.2026**

**RISHPALLJE**

**FTESË PËR SHPREHJE INTERESI**

Për recensentë mësimdhënës universitar, mësimdhënës lëndor dhe pedagog/psikolog për vlerësimin e dorëshkrimeve për tekstet për lëndën: Gjuhë shqipe për komunitetet joshqiptare për klasat 3, 4 dhe 5, në bazë të konkursit të shpallur nga MASHTI, më datë 16 maj 2024.

**Përshkrimi i përgjithshëm i angazhimit:**

Recensentët do të jenë përgjegjës për vlerësim kritik dhe profesional të dorëshkrimit, tekstit shkollor apo materialit mësimor.

**Kriteret e përzgjedhjes për recensentë:**

- Përzgjedhja e recensentëve dhe përcaktimi për fushë/lëndë, do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara me Ligjin nr. 02/L-67 dhe UA nr. 18/2018.
- Recensentët duhet të kenë kompetencë profesionale për vlerësimin e aspekteve të caktuara të tekstit shkollor.
- Recensentët kërkohet të jenë nga profilet si në vijim:
  - (1) Mësimdhënës universitar/punonjës shkencor i lëndës: Gjuhë shqipe, me gradën më të lartë shkencore;
  - (2) Mësimdhënës i lëndës: Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare
  - (3) Pedagog/psikolog shkolle

**Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Letërnjoftimi i vlefshëm i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës;
- Curriculum Vitae (CV);
- Formulari i aplikimit;
- Dëshmi të kualifikimit;
- Dokumente të tjera që vërtetojnë përmbushjen e kushteve të konkursit.

**Shpjegime shtesë:**

- Afati për dorëzim të aplikacioneve është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e publikimit.
- Aplikacionet dorëzohen në kopje fizike në zarf të mbyllur në zyrën numër 4, në MASHTI.
- Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të informohen për rezultatin e aplikimit të tyre në kohën e duhur.
- Aplikimet e pranuar pas përfundimit të afatit të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Aplikimet që nuk janë në përputhje me kërkesat e kësaj thirrje apo që nuk i plotësojnë kërkesat thelbësore të specifikuar në Konkurs, nuk do të merren parasysh.